



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi, Kryeprefekt i Komunës Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 11.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-5844 nga viti 2019, formuar pas denoncimit anonim nr. 12-5844/1 me datë 02.12.2019 dorëzuar nga, Kryeprefekti i Komunës, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprimt të mëtutjeshëm në lëndën 12-5844 nga viti 2019, në rastin e lëndës vepron organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-5844 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-5844 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit me nr. 12-5844/1 me datë 31.12.2019, dorëzuar deri te Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi, Kryeprefekt i Komunës

Në denoncimin e dorëzuar janë shprehur akuza kundër kryeprefektit paraprak të Komunës, për veprim të mundshëm joligjor dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit në procedurë pas dorëzimit të kërkesës në vitin 2011 për legalizim të objekti të ndërtuar pa leje të personi nga dhe dyshime se nga përfundimi i procedurës është dëmtuar buxheti i shtetit në nivel lokal dhe është mundësuar që personi fizik i caktuar të fiton në pronë me vlerë të caktuar në mënyrë joligjore.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri në Prokurorinë themelore publike Gostivar për informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës. Me kërkesë të Komisionit shtetëror janë dorëzuar lajmërime me informacionet e kërkuara me shtojcë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë që ka në disponim për rastin, nga e KSHPK është caktuar gjendja faktike me sa vijon:

- Në denoncimin e dorëzuar theksohet, se në lidhje me procedurën e lëndës nga ana e Komunës, në denoncim/lejmërim e marrur nga tregues, kurse pas inspektimit në dokumentacionin me të cilin disponon Komuna erdhi në njohuri për procedurë të mundshme joligjore të ish –kryeprefektit gjatë veprimin në procedurën e lëndës për legalizim dhe për dyshime se nga përfundimi i procedurës është dëmtuar buxheti i shtetit në nivel lokal dhe se ekzistojnë elemente të korrupsionit nga fakti që personi me detyrë

zyrtare dhe autorizim mundësoi që person i caktuar fizik fitoi pronë në vlerë të lartë në mënyrë joligjore kurse nga ana tjetër institucioni në të cilin punon i shkaktoi dëmë kurse për vete përfitime të mundshme. Pas kërkesës së Komunës, është bërë ekspertizë të rastit dhe nga ana e Byros për ekspertizë gjyqësore është përgaditur gjendje dhe mendim nr./.... me datë 23.04.2019, kurse ekspertiza është bërë nga person kompetent me datë 24.12.2018 deri me 18.01.2019.

Nga ana e komunës, me qëllim që të caktohet gjendja faktike për rastin, është ngritur kallëzim penal për eks Kryeprefektin e Komunës së deri në Prokurorinë themelore publike në Gostivar për veprën Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit i cili në prokurori është vulosur me KO nr./..... dhe kallëzim penal kundër nga për ekzistimin e dyshimit se ka bërë veprë penale, Ndërtim pa leje të cilën në PTHP është vulosur me KO nr./.....

Parashtruesi, në cilësi të Kryeprefektit aktuar, e dorëzoi denoncimin e lëndës, duke pasë parasyshë faktin se deri në ditën e parashtrimin të denoncimit deri në KSHPK, PTHP Gostivar dhe pas ofrimit të dëshmimeve të shkruara me të cilët disponon Komuna e për rastin konkret dhe pas kalimit të një viti të plotë, nuk ka pasur asnjë veprim për lëndën për kallëzimet penale të dorëzuara. Në denoncimin deri në KSHPK, janë ofruar të gjitha dëshmitë e shkruara të cilat janë dorëzuar deri në prokurorinë themelore publike adekuate, që të mund KSHPK të vepron në kuadër të autorizimeve të veta në përputhje me ligjin dhe aktet interne, të vepron dhe ta hulumton rastin dhe të ngritë procedurë adekuate para organeve kompetente.

- Gjatë kontrollimeve të bëra është ardhur deri në njohur se:

- Me datë 24.06.2012, ka pasur shpallje në medime (.....) me titull Keqpërdorime (mallverzime) me ndërtimet ilegalem, shteti dorëzon kallëzim penal për kryeprefektë”, është publikur me informacione të fituara nga ana e burimeve kompetente për kontroll të komunave në zbatimin e procedurës për legalizim, kurse në të cilën theksohet se kryeprefektët dhe udhëheqës të sektorit për urbanizim ka marrë kallëzim penal dhe akuza për kundërvajtje përshkak të parregullsive në procesin e legalizimit të objekteve ilegale.
- Sipas njohurive të mediumit i cili e publikoi rastin, Inspektorati shtetëror administrativ bëri inspektime në 84 komuna në vend, që të shihet se si veprojnë me kërkesat për caktim të statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje. Gjatë asaj nga ana e inspektorëve nga Inspektorati shtetëror administrativ, janë dorëzuar kallëzime penale dhe akuza për kundërvajtje, kundër kryeprefektëve dhe udhëheqësve, përshkak të parregullsive në procesin e legalizimit të objekteve pa leje. Në publikim, në mes tjerash është publikuar dhe se Inspektorati shtetëror administrativ ka ngritur dhe procedura disiplinore kundër nënpunësve shtetëror, kurse për disa kryeprefektë janë ngritur edhe procedurë për barazim dhe se është dorëzuar edhe ftesë për barazim në Komunën e Vrapçishtës deri te Kryeprefektin
- Me datë 16.11.2020, me kërkesë të KSHPK është dorëzuar lajmërim nga PTHP Gostivar me të cilën lajmërohet se në këtë prokurori publike është dorëzuar kallëzim penal kundër personit, nga ana e Komunës, pas të cilës është vepruar dhe janë kërkuar të dhëna nga Komuna dhe janë dërguar ftesë për

ndëgjim për në datë 11.12.2020. Në prokurorinë e përmendur është formuar lëndë dhe pas kallëzimit penal kundër personit, të dorëzuar nga ana e Komunës pas të cilës është vepruar dhe janë kërkuar të dhëna nga Komuna dhe është dorëzuar ftesë për ndëgjim për me datë 11.12.2020. nga e theksuara del se para prokurorisë kompetente po bëhen procedura që janë në rrjedhë.

Në bazë të gjendjes faktike të caktuar, KSHPK konstatoi se në lidhje me akuzat e lëndës po zhvillohen procedura para organeve kompetente – Prokuroria themelore publike – Gostivar, pran së cilës të gjitha janë në rrjedhë dhe ende nuk është marrë vendim përfundimtar nga prokuroria publike. Duke pasë parasysh të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në rastin e lëndës, procedura duhet të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pas parasysh të theksuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dipozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 11 Dhjetor të viti 2020, me numër 12-3806/4

Dorëzuar deri te: arkiva dhe parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK

Punoi: J. C., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kyetar: Biljana Ivanovska